



Nr. 10/Prot

Datë, 31.08.2020

**VENDIM**  
**Nr. 27**

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATES PËR  
DREJTUESE TË NJËSISË BAZË, NË RAUNDIN E DYTË TË ZGJEDHJEVE NË  
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE, FAKULTETI I SHKENCAVE  
HUMANE, DEPARTAMENTI I EDUKIMIT.**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, neni 4, pika 10; në zbatim të Vendimit nr. 47, datë 04.08.2020, të Komisionit Institucional Zgjedhor, "Mbi caktimin e datës për zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në Universitetin e "Ismail Qemali" Vlorë,

**Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shkencave Humane**  
**VENDOSI:**

1. Të miratojë hapjen e procesit të reregjistrimit të kandidatës, PhD. Ilva Lamaj për Drejtuese të Njesisë Bazë, Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidatja paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës, kandidatës i jepet vërtetimi i regjistrimit nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit.
3. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe në faqen zyrtare [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Erjona Dervishaliaj (Kryetare e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit)**

**Elonora Hodaj (Anëtare)**

**Adelajda Beqaj (Anëtare/Studente)**

*Erjona Dervishaliaj*  
*Elonora Hodaj*  
*Adelajda Beqaj*

*[Signature]*